



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Nr. 3781 Prot

Tiranë, më 30/11 2018

Lënda: Amendament për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.”

Drejtuar: z. Gramoz RUÇI

KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË

I nderuar z.Kryetar,

Mbështetur në nenin 75, pika 4, të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, të bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

- **Pas nenit 1, shtohet një nen i ri me këtë përmbajtje:**

“Neni 1/1

Në nenin 8/1 “Të ardhura të përjashtuara”, pas pikës 13, shtohet pika 14 me këtë përmbajtje:
14. Të ardhurat e përfituara nga personat fizik ose juridikë, që ushtrojnë tërësisht veprimtarinë e shitjes së librave në mjedise tregtare.”

- **Neni 2, i projektligjit riformulohet me këtë përmbajtje:**

Neni 2

Në nenin 9 “Tarifat tatimore”, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Pika 2, ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Interesat nga huat, depozitat ose kontrata të ngjashme, të ardhurat nga e drejta e autorit ose pronësia intelektuale, si dhe të gjitha shpërblimet apo të ardhurat e tjera, që nuk parashikohen ndryshe në dispozita të tjera të këtij ligji, tatohen me 15 për qind

2. Pas pikës 2 shtohen pikat 3 dhe 4, me këtë përmbajtje:

“3. Dividendët, të ardhurat që rrjedhin si fitim i ortakut, qoftë ky ortak i vetëm, tatohen me 8 për qind.

4. Të ardhurat bruto nga loja, për të gjitha kategoritë e lojërave të fatit tatohen në masën 15 për qind, me përjashtim të kategorive “Kazino”/ “Kazino në hotele me 5 yje” dhe “Resort kazino” të cilët tatohen në masën 30 për qind.”

• **Në nenin 7, bëhet ndryshimi dhe shtesa, me këtë përmbajtje:**

1. Shkronja ë), e pikës 1.1, ndryshohet me këtë përmbajtje:

ë) të ardhurat e individëve nga lojërat e fatit me përjashtim të kategorive “Kazino”/ “Kazino në hotele me 5 yje” dhe “Resort kazino”.

2. Pas pikës 1.2, shtohet pika 1.3, me këtë përmbajtje:

“1.3 30 për qind për

- a) kategoritë lojërave të fatit “Kazino”/ “Kazino në hotele me 5 yje” dhe
- b) kategoritë lojërave të fatit “Resort kazino”.

• **Neni 8, i projektligjit, riformulohet me këtë përmbajtje:**

Neni 8

Në nenin 38 “Dispozita kalimtare”, bëhet ndryshimi dhe shtesa, si më poshtë vijon:

1. Në paragrafin e dytë, të pikës 7, fjalia e parë, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Tatimi mbi lojërat e fatit, aplikohet me shkallën 15 për qind mbi të ardhurat bruto nga loja për të gjitha kategoritë e lojërave të fatit, përfshirë Lotarinë Kombëtare të licencuar sipas ligjit nr. 95/2013, me përjashtim të kategorive “Kazino”/ “Kazino në hotele me 5 yje” dhe “Resort kazino” të cilët tatohen në masën 30 për qind.”

2. Shtohet pika 9, me këtë përmbajtje:

“9. Norma e tatimit mbi dividendin në shkallën 8% do të aplikohet edhe për fitimet e pashpërndara të realizuara në vitet 2018 e më parë, përfshirë rezervat dhe fitimet e kapitalizuara, me kusht që tatimi mbi dividendin, që i përket fitimeve të pashpërndara të viteve 2017 e më parë, të paguhet brenda datës 30 shtator 2019, ndërsa tatimi mbi dividendin për fitimin e vitit 2018 të paguhet brenda datës 20 gusht 2019.”.

- Pasqyra nr.1 “Tabela për tatimin mbi të ardhurat personale nga punësimi”, bashkëlidhur projektligjit, zëvendësohet me pasqyrën nr.1 si më poshtë vijon:

Pasqyra nr.1

TABELA PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT PERSONALE NGA PUNËSIMI

E ardhura e tatueshme (në lekë/muaj)		Përqindje
Nga	Deri në (përfshirë)	
0	40.000	Zero për qind
40.001	150 000	+13 për qind të shumës mbi 40 000 lekë.
150 001	Më tepër	15 600 lekë + 23 përqind të shumës mbi 150 000 lekë.

DEPUTETI

Erjon BRACE